



REPUBLIKA E KOSOVËS  
 REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
 KOMUNA E GJAKOVËS  
 OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

**Kuvendi i Komunës së Gjakovës**

**01 Nr. \_\_\_\_\_/2026**

**Datë: 31.03.2026**

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe në nenin 15 të Statutit të Komunës së Gjakovës 01 nr011/04-29365 i datës 30.12.2022, Nenin 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 31.03.2026 pas diskutimit lidhur me pikën e 10 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për formimin e komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të Pronës së paluajtshme Komunale me numër të ngastrës P-70705029-05765-1 Z.K Gjakovë Qytet, e miratoi këtë:

**V E N D I M**

1. Formohet Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të Pronës së paluajtshme Komunale me numër të ngastrës P-70705029-05765-1 Z.K Gjakovë Qytet, me këtë përbërje:
  1. z. Zeq Tahiraj, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës.
  2. z. Ferdinand Kolaj, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës.
  3. znj. Adelina Shehu Kola, përfaqësuese e Kuvendit të Komunës.
  4. znj. Nita Efendia Brovina, përfaqësuese e Kuvendit të Komunës.
  5. znj. Brilanda Ballata, përfaqësuese e sektorit jo qeveritar.
2. Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale ka për detyrë dhe përgjegjësi që ti zhvilloj procedurat e parapara me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale për pronën e cekura në pikën 1 të këtij vendimi për të cilin është nxjerrë vendimi paraprak nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .
4. Vendimi iu dërgohet:
  - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini.
  - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
  - Anëtarëve të Komisionit Vlerësues.
  - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
  - Arkivit .



Shefqet Shehu

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës